

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 10¹ dhe 13, neni 24 dhe neni 79 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) nënparagrafët 8 dhe 11 dhe neni 59 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-3632/1 datë 22.8.2025 dhe neni 51 paragrafët 1 dhe 2 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), duke vepruar sipas Kërkesës për vazhdimin e lejes për transmetim në RA të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, PA1 nr.08-58 datë 9.1.2026, në seancën e 1-rë të mbajtur më 14.1.2026, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-174/4 datë 14.1.2026 miratoi si vijon:

VENDIM
për vazhdimin e lejes për radiotransmetim të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive
RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë

1. Leja për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, PA1 nr.08-58 datë 14.2.2017, i vazhdohet për një kohë prej 9 (nëntë) vitesh, për periudhë nga data 17.1.2026 deri më 16.1.2035.
2. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, në pajtim me pikën nr.1 të këtij Vendimi, do t'i japë leje të re.
3. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, për periudhën për të cilën vazhdohet leja, është e detyruar të punojë në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Ligjin për Media, rregulloret e miratuara në bazë të tij, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje.
4. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
5. Padia nuk e shtyn zbatimin e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Në nenin 79 (Kohëzgjatja e lejes për transmetim televiziv ose radio) paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele - LSHMAAV, përcakton se leja për transmetim televiziv ose radio, Shoqërive Tregtare Radiodifuzive dhe Institucioneve Radiodifuzive Jofitimprurëse i ndahet për periudhë kohore prej nëntë vitesh me mundësi për vazhdimin e saj.

Në pajtim me nenin 79 paragrafi (2) të LSHMAAV, leja për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i bartet personi tjetër.

Leja për transmetim televiziv ose radio në pajtim me nenin 79 paragrafi (3) të LSHMAAV mund të vazhdohet me kërkesë të bartësit për një kohë prej nëntë vitesh. Kërkesa

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: neni 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 248/18).

i dorëzohet Agjencisë në afati prej gjashtë muajsh para skadimit të vlefshmërisë së lejes. Këshilli i Agjencisë detyrimisht miraton vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me të cilën i vazhdohet leja, nëse transmetuesi nuk ka kryer shkelje në pajtim me paragrafin (4) të Ligjit.

Në pajtim me nenin 79 paragrafi (4) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë miraton vendim për refuzim të kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi ka kryer shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes përkatësisht: - së paku tre herë gjatë kohëzgjatjes së lejes kryen mosrespektim të ndalesave të veçanta të nenit 48 të Ligjit, për të cilat ka aktvendim gjyqësor të formës së prerë ose – gjatë kohëzgjatjes së lejes, së paku në një cikël zgjedhor të mbulimit mediatik nuk është kryer në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshëm, për të cilat ka aktvendim gjyqësor të formës së prerë.

SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, është zotërues i Lejes për radiotransmetim, PA1 nr.08-58 datë 14.2.2017, me vlefshmëri prej 9 (nëntë) vitesh, duke filluar nga 17.1.2017 deri më 16.1.2026, për transmetim nëpërmjet transmetuesit tokësor, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, shërbim programor radio folëse-muzikore me format kryesisht të përgjithshëm informativ, në gjuhën shqipe.

Në ueb-faqen e Agjencisë, është publikuar formular me Kërkesë për vazhdim të lejes për transmetim TV/RA. Shtojcat e Kërkesës për vazhdim të lejes për transmetim TV/RA janë: Dokument i përshtatshëm si provë se transmetuesit nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për ushtrimin e veprimtarisë nga regjistri ose evidencë (në origjinal ose kopje e noterizuar dhe jo më e vjetër se 15 ditë nga data e dorëzimit), ose deklaratë nga drejtuesi i radiodifuzerit se nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për kryerje të veprimtarisë, e noterizuar (dhe jo më e vjetër se 15 ditë nga data e dorëzimit); Deklaratë nga transmetuesi, e noterizuar se do t'i përmbahet karakteristikave teknike dhe parametrave të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (AKE) në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike (LKE) dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij; do t'i përmbahet kushteve teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për transmetim televiziv dhe radio të miratuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale; nuk shkel dispozitat e Kapitullit IV të LSHMAAV dhe të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha bashkëngjitet janë të besueshme dhe të vlefshme, si dhe Pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale të cekura në Kërkesë për vazhdimin e lejes për transmetim TV/RA. Formularët e deklaratave që i bashkëngjiten Kërkesës janë publikuar në ueb-faqen e Agjencisë.

Me datë 9.1.2026, SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, në pajtim me nenin 79 paragrafi (3) të LSHMAAV, ka paraqitur Kërkesë për vazhdimin e lejes për radiotransmetim (PA1 nr.08-58 datë 9.1.2026) në formularin përkatës të publikuar në ueb-faqen e Agjencisë. Pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitur, u përcaktua se ishte e rregullt dhe e plotë dhe përmbante të gjitha shtojcat (ndaj formularit të kërkesës), përkatësisht: Deklaratë nga Besim Shabani e dhënë në cilësinë e drejtuesit të transmetimit SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë se radiodifuzerit nuk i është shqiptuar masë sigurie ndalesë për kryerje të veprimtarisë, e noterizuar (dhe jo më e vjetër se 15 ditë nga data e paraqitjes) - nr.UZP 274/2026 datë 8.1.2026; Deklaratë nga Besim Shabani dhënë në cilësinë si themelues/pronar i vetëm i transmetuesit (e noterizuar) nr.UZP 272/2026 datë 8.1.2026 dhe Deklaratë nga Besim Shabani dhënë në cilësinë e drejtuesit të radiodifuzerit (e noterizuar) nr.UZP 273/2026 datë 8.1.2026, se SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë do të respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me LKE dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij; do të respektojë kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrje të lejes për transmetim televiziv dhe radio të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale; nuk shkel dispozitat e Kapitullit IV të LSHMAAV dhe se të dhënat e paraqitura në kërkesë janë të sakta dhe të gjitha bashkëngjitet janë të besueshme dhe të vlefshme, si dhe Pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale të cekura në Kërkesë, të dhënë nga drejtuesi i radiodifuzerit.

Nga Agjencia u konstatua se gjatë kohëzgjatjes së lejes, kërkuesi - SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 79 të LSHMAAV, përkatësisht nuk ka kryer shkelje serioze të cekura në nenin 79 paragrafi (4) të LSHMAAV.

Duke marrë parasysh sa më sipër, mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i Agjencisë në pajtim me Autorizimin, ark.nr.03-5648/1 datë 29.12.2025, drejtuar Këshillit të Agjencisë ka paraqitur Propozimin, PA1 nr. 08-58 datë 13.1.2026 për marrjen e

vendimit për vazhdim të Lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, PA1 nr.08-58 datë 14.2.2017, vlefshmëria e të cilit prej nëntë vitesh skadon më 16.1. 2026 dhe e njëjta të vazhdohet për një kohë prej 9 (nëntë) vitesh, përkatësisht nga data 17.1.2026 deri më 16.1.2035.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 10 dhe 13, neni 24 të LSHMAAV dhe neni 79 nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) nënparagrafët 8 dhe 11 dhe neni 59 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe neni 51 paragrafët 1 dhe 2 nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, duke vepruar sipas Kërkesës së paraqitur PA1 nr.08-58 datë 9.1.2026 për vazhdimin e lejes për radiotransmetim të SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, Këshilli i Agjencisë ka marrë Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit të tij do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në ueb-faqen e Agjencisë. SHTR RADIO JEHONA FM SHPKNJP Kumanovë, për vazhdimin e lejes nga pika numër 1. të këtij Vendimi, Agjencia do t'i japë leje të re. Transmetuesi është i detyruar për periudhën për të cilën vazhdohet leja të punojë në pajtim me LSHMAAV, LM, rregulloret e miratuara në bazë të Ligjit, si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje. Padia nuk e shtyn zbatimin e këtij Vendimi.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, transmetuesi i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të Vendimit.